



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më.13.4.2017, në ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Zenun Pajaziti, Shqipe Pantina dhe Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: kryeshefi i ASK-së, përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të ZKM-së, IPKO, OSBE, INPO, Epoka e re, Ekonomia-online.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Drita Morina dhe Mirjeta Heta.**

Mbledhjen e kryesoi, Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit, me këtë rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës

Xhevahire Izmaqu, njoftoi komisionin, që kryeshefi ekzekutiv, është ftuar për të njoftuar komisionin për arsyet e iniciativës së ASK-së, për plotësim-ndryshimin e Ligjit për statistikën zyrtare të Kosovës.

Isa Krasniqi, kryeshef ekzekutiv i ASK-së, tha se domosdoshmëria e ndryshimit të Ligjit për statistikën zyrtare, është rekomandim i Eurostat-it (Qendra e Statistikave Evropiane) që dy çështje të cilat duhet të ndryshohen, janë:

Mandati i kryeshefit ekzekutiv, të ndryshohet prej trivjet sa është aktualisht, në shtatëvjet, dhe çështja e vendosjes së Agjencisë së Statistikave, si agjenci e Qeverisë apo Kuvendit të Kosovës, me qëllim të ruajtjes dhe fuqizimit të pavarësisë institucionale të ASK-së.

Mentor Borovci, drejtor i Zyrës Ligjore të ZKM-së, lidhur me çështjet e diskutuara, së pari Projektligji për ASK-në është i ndërlidhur me disa ligje në fuqi, Ligjin e administratës shtetërore, me të cilin përcaktohen konturat e brendshme të organizimit të administratës shtetërore, si dhe Ligjin për shërbimin civil dhe rregulloren, sipas së cilës, caktohen edhe mandatet e pozitive të larta drejtuese, ndër të cilat është edhe pozita e kryeshefit ekzekutiv të ASK-së.

Qeveria është në procedurën e plotësimit-ndryshimit të disa ligjeve: për shërbimin civil, pagat e nëpunësve civil, në të cilat ndryshime do të përfshihen edhe mandatet për pozitë të larta drejtuese, andaj nuk është e domosdoshme, që me ndryshimin e Ligjit për statistikën zyrtare, të përfshihet edhe mandati i kryeshefit ekzekutiv. Gjithashtu, në nenin gjashtë të ligjit, ASK-ja është institucion i pavarur dhe profesional, dhe pavarësisht se a caktohet me vendim të Qeverisë, si institucion i Qeverisë apo në kuadër të Ministrisë së Financave, kjo nuk nënkupton se do të cenohet pavarësia funksionale e ASK-së.

Lahi Brahimaj, pyeti përfaqësuesit e Qeverisë dhe kryeshefin e ASK-së, lidhur me arsyet dhe mospajtimet që të mbetet apo jo ASK-ja, në kuadër të Qeverisë.

Isa Krasniqi, u përgjigj, se ASK-ja, në të gjitha vendet e rajonit, është në kuadër të Qeverisë apo edhe Kuvendit, por mbetja e ASK-së si agjenci, në kuadër të Ministrisë së Financave, përveç regreseve të tjera, do të ketë edhe regres buxhetor.

Agim Kikaj, duke iu drejtuar kryeshefit ekzekutiv, tha se pavarësia institucionale e ASK-së nuk varet nga fakti se në kuadër të kujt është vetë institucioni, por pavarësinë institucionale e garanton ligji. Lidhur me këtë, nuk është e motivuar këmbëngulja dhe rekomandimet e juaja dhe e Eurostat-it për plotësimit-ndryshimin e ligjit në fuqi.

3. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi shkresën e IPKO-s, adresuar komisionit, për të informuar lidhur me mosshqyrtimin e ankesave të IPKO-s nga Komisioni i Pavarur i Mediave, për veprimet ilegale të operatorëve IPTV.

Konstatim: Komisioni vendosi që të kërkohet përgjigje me shkrim nga KPM-ja dhe çështja të diskutohet përsëri në mbledhjen e radhës, kur edhe shqyrtohet raporti vjetor i KPM-së.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Xhevahire Izma